



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 26/09/2025

PROCES VERBAL

Dëgjese Publike për taksën e fjetjes në strukturat akomoduese

Vendi : Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Përmet

Ora : 10:00

Tema e konsultimit : Taksa e fjetjes në strukturat akomoduese

I mbajtur sot më datë 26 Shtator, pranë sallës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Të pranishëm në këtë konsultim janë nënkryetari i Bashkisë z.Florand Hasani, Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësi, Turizëm znj.Etleva Myftari, Kryetare e Këshillit Bashkiak znj.Anila Dhimitri si dhe subjekte të ndryshme që ofrojnë shërbim në fushën e hotelerisë dhe shtëpive pritëse.

Takimi u hap nga z.Hasani i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë. Më pas ai i falenderoi ata lidhur me punën e palodhur në sektorin e turizmit si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë lokale. Gjithashtu ai theksoi se përsëri fokusi i Bashkisë do të jetë turizmi dhe do të vazhdojë të ketë në prioritetet e saj investime që ta risin sa më shumë cilësinë dhe standardin e saj.

Pas tij fjalën e mori znj.Myftari e cila kërkoi nga subjektet bashkëpunim për të mirën e përbashkët. Gjithashtu i falenderoi subjektet të cila kanë shlyer detyrimet dhe kërkoi një angazhim maksimal nga ana e drejtorisë së saj për të identifikuar cdo subjekt dhe mbledhur cdo detyrim të tyre duke i trajtuar të gjithë në mënyrë të barabartë.

Në përfundim të fjalës së saj ajo kërkoi mendime dhe sugjerime nga të pranishmit. Disa nga sugjerimet e këtij takimi janë :

- Si do të grumbullohet me efikasitet taksa e fjetjes ?
- A janë të gjitha subjektet që ofrojnë shërbim të lishensuara ?
- Si do të luftohet informaliteti ?
- A janë të evidentuara të gjitha subjektet që ofrojnë këtë shërbim ?

Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik ju përgjigj pyetjeve të mësipërme duke sqaruar që angazhimi do të jetë maksimal nga sektori i Tatim-Taksave për mbledhjen e kësaj tarife. Mbledhja e kësaj tarife do të jetë sipas kategorisë dhe numrit të shtretërve të strukturave akomoduese. Tashmë janë identifikuar të gjitha subjektet formale dhe joformale dhe të gjithëve ju lind detyrimi . Në vijim fokusi i bashkisë do të jetë formalizimi i këtyre strukturave. Bashkëpunimi i bashkisë mbetet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

gjithmonë i hapur për cdo subjekt. Hapi i rradhës është miratimi i tarifës në Këshillin Bashkiak për të vijuar me bërjen pjesë të dokumentit të Paketës Fiskale për vitin 2026.

Takimi u mbyll në orën **11:00**.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Denisa DURRO




Foto nga takimi:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

